




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	Nr. Prot. Br. Prot. Prot No.
DPKI	06-1399/20
Nr. lfaq. Braj shtabes Nr. pagës	Data Datum Date
02	30.06.2020
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 29.06.2020, mori:

V E N D I M

- I. Mbyllet rasti me Nr. **AKK-DPKI-06/2848/19**, për zyrtarin e lartë z. Adrian Berisha, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Prishtinës, për shkak së është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë në rast se paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Në rastin e shqyrtuar për konflikt të interesit me numër protokolli: AKK-DPKI-06/2848/19, që për trajtim ka pasur zyrtarin e lartë z. Adrian Berisha, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Prishtinës, është zhvilluar procedura e paraparë sipas Ligjit Nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), pasi ka identifikuar rastin për zyrtarin e lartë z. Adrian Berisha, Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Prishtinës, ka verifikuar informacionin, ku i njëjti figuronte si person i autorizuar në biznesin individual “ Adrian Berisha B.I. ” me nr. biznesi 810961377. Agjencia kundër Korrupsionit, fillimisht me shkresën zyrtare DPKI-06-2564/19, ka kërkuar nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtutjeshëm: ARBK), verifikimin dhe konfirmimin e informacionit lidhur me biznesin e cituar mësipër. Nga përgjigja e ARBK-së (shkresa zyrtare nr. DPKI-06-2388/19), rezulton se zyrtari i lartë z. Adrian Berisha, është person i autorizuar në biznesin në fjalë.



Agjencia në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit, përmes shkresës zyrtare AKK-DPKI-06/414/20, dhe se në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të kësaj shkrese, ai ka të drejtë të njoftohet gjerësisht me faktet që posedon Agjencia lidhur me rastin në fjalë.

Pas pranimit të kësaj shkrese nga pala, me kërkesë të tij është organizuar dhe mbajtur një takim brenda Agjencisë, ku zyrtari i lartë është njoftuar gjerësisht lidhur me faktin se, ushtrimi i funksionit të zyrtarit të lartë Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Prishtinës si dhe të qënurit njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat, paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, situatë e cila është në kundërshtim me nenin 13, paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, ku përcaktohet se:

“Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit”.

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Adrian Berisha, është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, ka deklaruar se do të ndërmarr veprime tjera konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë me datë 26.06.2020, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresë zyrtare me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Adrian Berisha, ka bërë ndryshimet e nevojshme dhe se i njëjti nuk figuron më të jetë person i autorizuar në biznesin individual “ Adrian Berisha B.I.”.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë z. Adrian Berisha, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit Nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

